



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr.182/ 10 prot

Datë 16.02.2024

V E N D I M
Nr. 185 /2024

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Anila Malaj	Anëtar
Kreshnik Ternova	Anëtar

Në mbledhjen e datës 16.02.2024 me:

Objekt:

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi kualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “INSTANT.AL” SHPK në procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur e Thjeshtuar”, me Nr. REF-87877-11-15-2023, me objekt “Blerje Kompjutera dhe printer për nevoja të Bashkisë Shijak”, me fond limit 2,500,000 Lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 12.01.2024, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Shijak.

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi kualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “Blueprint Technologies” SHPK në procedurën e prokurimit sipër cituar.

Ankimues:

Operatori ekonomik “PC STORE” SHPK, *me Nipt*
L01606034A
Adresa: Rruga e Dibrës, vila 153, kati 1, Tiranë.

Autoriteti Kontraktor:

Bashkia Shijak.
Adresa: Lagjja “Erzen” Shijak.

Subjekte të Interesuar:

Operatori ekonomik “INSTANT.AL” SHPK, *me Nipt.*
L81506043D Adresa: Rr. Idriz Dollaku, L. Ali Demi,
Apartamenti 2, shkalla 1, kati i pare, Tiranë.

Operatori ekonomik “Blueprint Technologies” SHPK me NIPT L82428011G. Adresa: Rruga “Fortuzi”, Nr. 66/1, Tiranë.

Baza Ligjore:

Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID - 19”.

Komisioni i Prokurimit Publik pasi shqyrtoi ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik ankimues, Informacionin e autoritetit kontraktor dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Vlëra limit e përlllogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është nën kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga tre anëtarë, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

I.4. Operatori ekonomik ankimues ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 17.11.2023, është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, procedura e prokurimit “Procedurë e Hapur e Thjeshtuar”, me Nr. REF-87877-11-15-2023, me objekt

“Blerje Kompjutera dhe printera për nevoja të Bashkisë Shijak”, me fond limit 2,500,000 Lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 12.01.2024, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Shijak.

II.2. Në datë 12.01.2024, autoriteti kontraktor zhvilloi procedurën e prokurimit objekt-ankimi.

II.3. Nga verifikimi në sistemin e prokurimit elektronik (SPE), si dhe referuar informacionit të autoritetit kontraktor, të dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, rezulton, se në datën 22.01.2024, është bërë klasifikimi i operatorëve ekonomikë pjesëmarrës duke i njoftuar me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të ofertave ekonomike si më poshtë:

1. Infocodify SHPK	me ofertë	2,7767. ⁷⁵ Lekë pa TVSh	Skualifikuar
2. INSTANT.AL. SHPK	“	2,096,100 “	kualifikuar
3. Blueprint Technologies SHPK	“	2,184,000 “	kualifikuar
4. PC STORE SHPK	“	2,227,000 “	kualifikuar
5. ATOM SHPK	“	2,285,400 “	kualifikuar
6. OPTIMA COMMUNICATION SHPK “	“	2,440,000 “	kualifikuar

II.4. Në datën 23.01.2024, autoriteti kontraktor ka publikuar njoftim - fituesi paraprak në Sistemin e Prokurimeve Elektronike.

II.5. Nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik si edhe pranë autoritetit kontraktor, është administruar ankesa me nr. ankimi elektronik A/2024/3774, datë 26.01.2024, dhe nr. 182/2024 Prot., date 26.01.2024, e operatorit ekonomik “PC STORE” SHPK, për procedurën e prokurimit “*Procedurë e Hapur e Thjeshtuar*”, me Nr. REF-87877-11-15-2023, me objekt “Blerje Kompjutera dhe printer për nevoja të Bashkisë Shijak”, me fond limit 2,500,000 Lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 12.01.2024, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Shijak.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës së sipërcituar, u konstatua, se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi kualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “INSTANT.AL” SHPK dhe operatori ekonomik “Blueprint Technologies” SHPK.

II.6. Në përputhje me nenin 112 “*Veprimet paraprake*” të Ligjit nr.162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe është publikuar formulari i publikimit Nr. 182/2 prot., datë 26.01.2024 lidhur me pretendimet e ankimuesit “PC STORE” SHPK.

II.7. Nëpërmjet shkresës me nr. 6 Prot., datë 28.01.2024, protokolluar me tonën me nr.182/3, datë 29.01.2024, me objekt “*Formular i paraqitjes së argumenteve*” online nga operatori ekonomik “INSTANT.AL”SHPK, në përmbushje të nenit 113, të Ligjit Nr.162/2020 “Për

Prokurimin Publik”, me anë të së cilës kundërshton ankesën e operatorit ekonomik “PC STORE” SHPK.

II.8. Nëpërmjet shkresës përcjellë në Sistemin e Ankesave Elektronike me nr. 447 prot., datë 29.01.2024, protokolluar me tonën me nr. 182/4, datë 29.01.2024, autoriteti kontraktor ka paraqitur “*Informacion*” pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si dhe vendimin me Nr.20, datë 29.01.2024, mbi trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues “PC STORE” SHPK, duke vendosur mospranimin e saj.

II.9. Referuar ankesës mbi pretendimet e ankimuesit për operatorin ekonomik “INSTANT.AL”SHPK, Komisioni i Prokurimit Publik, me shkresën me nr. 182/5 Prot., datë 05.02.2024, me objekt: *Mbi detyrimin e autoritetit kontraktor për dhënie informacioni KPP-së lidhur me ankesën e operatorit ekonomik “INSTANT .AL” SHPK*, i kërkoi Autoritetit kontraktor, dokumentacionin e plotë të dorëzuar nga operatori ekonomik “INSTANT.AL” SHPK.

II.10. Nëpërmjet shkresës me nr.577/1 Prot., datë 08.02.2024, protokolluar me tonën me nr. 182/7, datë 12.02.2024, me objekt “*Informacion*” Bashkia Shijak, ka përcjellë pranë KPP-së kopje të dokumentacionit të ofertës së operatorit ekonomik “INSTANT.AL”SHPK.

III

Komisioni i Prokurimit Publik,

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur si dhe informacionit të autoritetit kontraktor,

Arsyeton:

III.1. Lidhur me ankesën e operatorit ekonomik ankimues “PC STORE”SHPK ku ngre pretendime për mospërbushje të kriterit 2.3.2 nga operatori ekonomik “Blueprint Technologies” SHPK. me argumente si vijon:

Dyshojmë se OE Blueprint Technologies ShPK nuk plotëson kërkesën 2.3.2 Operatorët ekonomikë ofertues duhet të plotësojnë dhe të dorëzojnë së bashku me dokumentet e tjera, skedën teknike për artikujt objekt - prokurimi, sipas tabelës së mëposhtme:

A	B	C
Nr.	Emërtimi i artikullit	Kompania prodhuese
1	KOMPJUTER All-In-One (AiO) 23"	
2	KOMPJUTER All-in-One (AiO) 24"	
3	PRINTER B&W Advanced	
4	FOTOKOPJE Multifunction Color Copy Machine A4	

Pra duke u bazuar në pikën 2.3.2, OE duhet të dorëzojnë skedën teknike (katalogët) për produktet sipas tabelës së mësipërme, kemi informacione dhe dyshime të arsyeshme bazuar

në indicje reale, që OE Blueprint Technologies nuk plotëson pikën 2.3.2 në DST e procedurës objekt të këtij ankimi, pasi nuk ka dorëzuar në SPE skedat teknike për produktet KOMPJUTER All-In-One (AiO) 23", KOMPJUTER All-in-One (AiO) 24", PRINTER B&W Advanced, FOTOKOPJE Multifunction Color Copy Machine A4

III.1.1 Autoriteti kontraktor ka publikuar në SPE shtojcën 5 dhe shtojcën 7, të modifikuara si vijon:

Shtojca 5.

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Përshkrimi i Specifikimeve Teknike të mallrave objekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve plotësisht të justifikuara, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh kriteret e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi.

SHËNIM: Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent".

Skicimet, parametrat teknik etj:

Specifikimi i Materialeve:

Përshkrimi i të dhënave teknike të mallrave objekt prokurimi të përshkruara sa më saktë dhe në mënyrë të plotë, duke krijuar kushte për konkurrim të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve. Kur është e mundur, specifikimet teknike duhet të përcaktohen në mënyrë të tillë që të kuptohen nga personat me aftësi të kufizuara.

Keto kërkesa janë hartuar ne perputhje me parashikimet e dispozitave ligjore/nenligjore

1. KOMPJUTER All-In-One (AiO) 23"

KARAKTERISTIKA MINIMALE TEKNIKE	
<i>Pikët Min. për Procesorin sipas: cpubenchmark.net Min Proc. Rating According to: cpubenchmark.net:</i>	<i>11,000 Pikë</i>
<i>"Chipset":</i>	<i>Intel ose Ekuivalent</i>
<i>"RAM":</i>	<i>16 GB, min. DDR4 2666 MHz</i>
<i>Madhësia e Solid-state Drive "SSD Size":</i>	<i>512 GB SSD</i>
<i>"Graphics":</i>	<i>Integrated HD Graphics</i>
<i>Ekrani "Display":</i>	<i>23" Min. FHD (1920x1080) LED Backlight, Anti-Glare</i>

"Web Camera":	Min. FHD Camera
"Speakers":	Internal Stereo Speakers
Ushqimi "Power Supply":	220 V AC, 50 Hz
KOMUNIKIMI & MENAXHIMI	
Portat e Komunikimit "Ports":	Min. (5) USB nga të cilat min. (2) USB 3.0; (1) RJ-45; (1) DP/HDMI Min. (1/1) Headphone/Microphone Jack ose (1) Combo Jack; (1) Integrated Mic.;
Rrjeti "Networking":	10/100/1000 Mbps LAN (RJ-45); Wireless 802.11ac (Kompatibël me 802.11b/g/n); Bluetooth min. V4.1
Sistemi i Operimit "Preinstalled Licensed O. S.":	OEM Windows 10 64-bit Professional
Tastiera "Keyboard":	Standart Keyboard QWERTY
"Pointing Device":	Standart Optical Mouse
Siguria "Security":	Embedded Security TPM 2.0
AKSESORËT	
Kabëll "Power Cord":	Po, European
"Recover":	Recover Partition
Të tjera:	Energy Star
GARANCIA	
Periudha e Mbulimit të Garancisë "Warranty":	3 Vjet

2. KOMPJUTER All-in-One (AiO) 24"

KARAKTERISTIKA MINIMALE TEKNIKE	
Pikët Min. për Procesorin sipas: <i>cpubenchmark.net</i> Min Proc. Rating According to: <i>cpubenchmark.net</i> :	15,000 Pikë
"Chipset":	Intel ose Ekuivalent
"RAM":	16 GB, min. DDR4 2666 MHz
Madhësia e Solid-state Drive "SSD Size":	512 GB SSD
"Graphics":	Integrated HD Graphics
Ekrani "Display":	24" Min. FHD (1920x1080) LED Backlight, Anti-Glare
"Web Camera":	Min. FHD Camera
"Speakers":	Internal Stereo Speakers
Ushqimi "Power Supply":	220 V AC, 50 Hz
KOMUNIKIMI & MENAXHIMI	
Portat e Komunikimit "Ports":	Min. (5) USB nga të cilat min. (2) USB 3.0; (1) RJ-45; (1) DP/HDMI Min. (1/1) Headphone/Microphone Jack ose (1) Combo Jack; (1) Integrated Mic.;
Rrjeti "Networking":	10/100/1000 Mbps LAN (RJ-45); Wireless 802.11ac (Kompatibël me

	802.11b/g/n); Bluetooth min. V4.1
Sistemi i Operimit "Preinstalled Licensed O. S.":	OEM Windows 10 64-bit Professional
Tastiera "Keyboard":	Standart Keyboard QWERTY
"Pointing Device":	Standart Optical Mouse
Siguria "Security":	Embedded Security TPM 2.0
AKSESORËT	
Kabëll "Power Cord":	Po, European
"Recover":	Recover Partition
Të tjera:	Energy Star
GARANCIA	
Periudha e Mbulimit të Garancisë "Warranty":	3 Vjet

3. PRINTER B&W Advanced

KARAKTERISTIKA MINIMALE TEKNIKE	
Shpejtësia e Printimit "Print Speed" A4:	≥ 45 ppm
Cikli Mujor i Punës "Monthly Duty Cycle":	60 000 Faqe
Teknologjia "Technology":	Laser
Rezolucioni i Printimit Minimal "Print Quality":	1200x1200 dpi
Kapaciteti në Hyrje "Input Capacity"	500 Fletë
Pesha Specifike e Letrës "Media Sizes":	60-120 g/m ²
Formati i Letrës "Media format":	A4/A5/Envelope
Aftësia e Printimit Duplex:	Po
Memorja "Memory":	≥ 256 MB
"Toner":	Shoqëruar me Starter Kit
KOMUNIKIMI & MENAXHIMI	
Porta e Komunikimit "Interface":	High Speed USB 2.0
"Ethernet":	Po
AKSESORËT	
Kabëll "Power Cord":	Po, European
Software/Drivers CD:	Po
Kabëll USB:	Po
GARANCIA	
Periudha e Mbulimit të Garancisë "Warranty":	2 Vjet
Pjesët e konsumueshme janë drum-i dhe toneri.	

4. FOTOKOPJE Multifunction Color Copy Machine A4

KARAKTERISTIKA MINIMALE TEKNIKE	
"Model":	Copier, Printer, Scanner
Shpejtësia "Copy/Print Speed for A4 B&W":	≥ 20 ppm
Cikli Mujor i Punës "Monthly Duty Cycle":	≥ 30 000 Faqe
Teknologjia "Technology":	Laser Color/B&W
Zvogëlim/Zmadhim "Reduction/Enlargement":	25% - 400%
Vendosja e Letrës "Document Feeder":	ADF
Sirtaret per Letrën "Paper Trays":	min 1
Kapaciteti në Hyrje "Input Capacity min.":	150 Fletë (jo Bypass)
Kapaciteti në Dalje "Output Capacity min. Standard":	100 Fletë

Kopjim/Printim në të dy Faqet "Duplex Copying/Print.":	Nuk Specifikohet
Formati i Letrës "Media Sizes":	A4
Memorja "Memory":	≥ 256 MB
"Hard Disk":	Nuk Specifikohet
Shpejtësia e Skanimit "Scan Speed":	Nuk Specifikohet
Rezolucioni i Skanimit "Scan Resolution":	600 dpi
Ushqimi "Power Supply":	220 V AC, 50 Hz
"Toner":	Shoqëruar me Starter Kit
KOMUNIKIMI & MENAXHIMI	
Porta e Komunikimit "Interface":	High Speed USB 2.0
"Ethernet":	Po
AKSESORËT	
Kabëll "Power Cord":	Po, European
Software/Drivers CD:	Po
GARANCIA	
Periudha e Mbulimit të Garancisë "Warranty":	1 Vit, 90 000 Kopje *
* Kush të arrihet më parë	
Pjesët e konsumueshme janë drum-i dhe toneri.	

Shtojca 7 KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT, 2.3 Kapacitet teknik,

2.3.2 Operatorët ekonomikë ofertues duhet të plotësojnë dhe të dorëzojnë së bashku me dokumentet e tjera, skedën teknike për artikujt objekt prokurimi, sipas tabelës së mëposhtme:

A	B	C
Nr.	Emërtimi i artikullit	Kompania prodhuese
1	KOMPJUTER All-In-One (AiO) 23"	
2	KOMPJUTER All-in-One (AiO) 24"	
3	PRINTER B&W Advanced	
4	FOTOKOPJE Multifunction Color Copy Machine A4	

III.1.2 Në nenin 2 "Qëllim" të ligjit nr. 162/2020 "Për Prokurimin Publik", parashikohet shprehimisht se: "Qëllim i këtij ligji është:

- a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;
- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik
- dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik."

Nënkohë në nenin 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet shprehimisht se:

“1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale.

2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar.

3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.”

III.1.3. Në nenin 36 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” parashikohet shprehimisht se:

“Specifikimet teknike, siç përcaktohen në nenin 4 të këtij ligji, duhet të përshkruhen në dokumentet e tenderit. Në specifikimet teknike përcaktohen qartë karakteristikat e punëve, shërbimit ose furnizimit që do të prokurohet.

Këto karakteristika mund të lidhen edhe me procesin specifik ose metodën e prodhimit ose ofrimit të punëve, furnizimeve ose shërbimeve të kërkuara ose me një proces specifik për një fazë tjetër të ciklit jetësor edhe kur këta faktorë nuk përbëjnë përmbajtjen e saj thelbësore nëse ato janë të lidhura me objektin e kontratës dhe proporcionale me vlerën dhe objektivat e saj.

Në specifikimet teknike mund të specifikohet edhe nëse do të jetë i nevojshëm transferimi i të drejtave të pronësisë intelektuale.

Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve të justifikuara plotësisht, hartohen në mënyrë të tillë që të marrin në konsideratë kriteret e aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuar ose projektimit për të gjithë përdoruesit, sipas kërkesave në legjislacionin në fuqi.

2. Specifikimet teknike duhet të mundësojnë trajtim të barabartë për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit dhe të mos shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik.

3. Specifikimet teknike duhet të përshkruajnë qartë kërkesat e autoritetit ose entit kontraktor, duke iu referuar:

a) kërkesave funksionale ose të performancës, përfshirë karakteristikat mjedisore, me kusht që parametrat të jenë të saktë në mënyrë që t’u japin mundësi ofertuesve të përcaktojnë objektin e kontratës dhe autoriteteve ose enteve kontraktore të japin kontratën;

b) standardeve kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimeve teknike ndërkombëtare, specifikimeve teknike të përgjithshme, standardeve ndërkombëtare apo sistemeve të tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit. Kur këto nuk ekzistojnë, ato u referohen standardeve kombëtare, miratimeve teknike kombëtare ose specifikimeve teknike kombëtare, që lidhen me projektimin, përlllogaritjen dhe ekzekutimin e punëve ose përdorimin e produkteve;

c) kërkesave në terma funksionalë sipas shkronjës “a”, referuar specifikimeve teknike sipas shkronjës “b” të kësaj pike, si mënyrë që nënkupton pajtueshmëri me kërkesat funksionale;

ç) të dyja metodave të përcaktuara në shkronjat “a” dhe “b” të pikës 3 të këtij neni, për mallra, shërbime ose punë të ndryshme, të përfshira në të njëjtin objekt kontrate. Çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

4. Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të këtij neni. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

5. Në rast se autoriteti ose enti kontraktor përcakton specifikimet teknike në bazë të shkronjës “b” të pikës 3 të këtij neni, nuk mund të refuzojë një ofertë me argumentin se punët, furnizimet apo shërbimet për të cilat është dorëzuar oferta nuk plotësojnë specifikimet teknike, të cilave u referohen, për sa kohë që ofertuesi provon në ofertën e tij me çdo mjet të përshatshëm që zgjidhjet e propozuara përmbushin kërkesat e përcaktuara në specifikimet teknike në mënyrë ekuivalente.

6. Në rast se autoriteti ose enti kontraktor përcakton specifikimet teknike në bazë të shkronjës “a” të pikës 3 të këtij neni, ai nuk mund të refuzojë një ofertë për punë, mallra apo shërbime, e cila është në përputhje me standardet kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimet teknike ndërkombëtare, specifikimet teknike të përgjithshme, standardet ndërkombëtare apo sistemet e tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit kur këto specifikime teknike përmbushin kriteret funksionale, të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor.”

III.1.4 Në nenin 40 pika 6, “Kërkesa të vecanta për kontratat e mallrave” të Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar citohet:

6. Autoriteti/enti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si:
- a) mostra të mallit, kur e gjykon se kjo ka rëndësi për vlerësimin e ofertës teknike. Në këtë rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të argumentojë kërkesën për mostrat. Mostrat duhet të trajtohen si informacion konfidencial tregtar dhe duhet të jenë në kontroll të autoritetit/entit kontraktor. Në rastin e procedurave të zhvilluara me mjete elektronike, autoriteti ose enti kontraktor përcakton qartë procedurën për dorëzimin e mostrave, duke garantuar aksesin e çdo operatori të interesuar si dhe konfidencialitetin për pjesëmarrjen në proces. Mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve pas nënshkrimit të kontratës, me kusht që kontrata në fjalë të mos jetë objekt i shqyrtimit administrativ apo gjyqësor. Në rastin kur procedura e prokurimit anulohet, mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së vendimit përfundimtar të anulimit; dhe/ose
 - b) fotografitë apo katalogët teknikë; dhe/ose
 - c) dëshmi për rezultatet e testimeve zyrtare, të lëshuara nga institucione të autorizuara, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike.

III.1.5. Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon, se autoritetet kontraktore në hartimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim, krahas përshkrimit të saktë të nevojave të këtij të fundit, duhet të kenë në vëmendje faktin, se hartimi i tyre duhet bërë në një mënyrë

gjithëpërfshirëse duke krijuar kushte për konkurrim të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve, duke përshkruar sa më saktë dhe në mënyrë të plotë karakteristikat e mallrave/shërbimeve/punëve dhe në përputhshmëri me objektin e kontratës. Për këtë qëllim ligjvënësi ka parashikuar se këto karakteristika mund të lidhen edhe me procesin specifik ose metodën e prodhimit ose ofrimit të punëve, furnizimeve ose shërbimeve të kërkuara ose me një proces specifik për një fazë tjetër të ciklit jetësor edhe kur këta faktorë nuk përbëjnë përmbajtjen e saj thelbësore nëse ato janë të lidhura me objektin e kontratës dhe proporcionale me vlerën dhe objektivat e saj. Ligjvënësi ka parashikuar qartësisht në nenin 36 pika 1 paragrafi 4 të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, se duhet të mundësojnë trajtim të barabartë për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit dhe të mos shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik.

Në respekt të parimit të mësipërm, specifikimet teknike, në asnjë rast nuk duhet të diskriminojnë/përjashtojnë nga konkurrimi operatorët ekonomikë ofertues dhe/ose prodhuesit qofshin këta kombëtar apo ndërkombëtar.

Autoriteti kontraktor me specifikimet teknike orienton operatorët ekonomikë në përgatitjen e ofertave. Operatorët ekonomikë janë pala e interesur në përmbushjen e specifikimeve teknike me mallrat që ata ofertojnë. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit, me dokumentacionin e dorëzuar, duhet të vërtetojnë, që produkti i ofruar është në përputhje me parametrat dhe specifikimet teknike e kërkuara nga autoriteti kontraktor. Operatorët ekonomikë ofertues marrin përsipër përmbushjen e specifikimeve teknike/ kriterëve të përcaktuara në dokumentet e tenderit nga ana e autoriteteve kontraktore, nëpërmjet deklaratave dhe dokumentacionit provues në të cilin duhet të faktojnë përputhshmërinë e dokumentacionit me kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor, në mënyrë që nga ana e këtij të fundit të mund të kryhet me lehtësi e saktësi vlerësimi i mallrave apo shërbimeve të ofertuara nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës, duke përzgjedhur atë ofertues, i cili me dokumentacionin e dorëzuar garanton përputhshmërinë me kriteret e përcaktuara në DT, e rrjedhimisht realizimin me sukses të kontratës objekt-prokurimi.

III.1.6. Komisioni i Prokurimit Publik vëren, se nga shqyrtimi i dokumenteve të tenderit të procedurës objekt - shqyrtimi, autoriteti kontraktor ka kërkuar shprehimisht, që operatorët ekonomikë pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi duhet të paraqesin:

2.3.2 *Operatorët ekonomikë ofertues duhet të plotësojnë dhe të dorëzojnë së bashku me dokumentet e tjera, skedën teknike për artikujt objekt - prokurimi, sipas tabelës së mëposhtme:*

A	B	C
Nr.	Emërtimi i artikullit	Kompania prodhuese
1	KOMPJUTER All-In-One (AiO) 23"	
2	KOMPJUTER All-in-One (AiO) 24"	
3	PRINTER B&W Advanced	
4	FOTOKOPJE Multifunction Color Copy Machine A4	

Operatori ekonomik në dokumentet e ofertës së hedhur në SPE, ka depozituar dokumentin emërtuar: *Shtojcat*. Referuar dokumentit Komisioni konstatoi, se operatori ka paraqitur në dokument kriterin 2.3.2 sipas DST dhe poshte tij ka plotësuar si vijon:

A	B	C
Nr.	Emërtimi i artikullit	Kompania prodhuese
1	KOMPJUTER All-In-One (AiO) 23"	HP ose Lenovo ose Dell
2	KOMPJUTER All-in-One (AiO) 24"	HP ose Lenovo ose Dell
3	PRINTER B&W Advanced	HP ose Lenovo ose Dell
4	FOTOKOPJE Multifunction Color Copy Machine A4	HP ose Lenovo ose Dell

Nënshkruar dhe vulosur nga Administratori i shoqërisë.

Operatori ekonomik, referuar dokumentit sipërcituar, nuk ka arritur të përmbushë specifikimet teknike me ofertën e tij për artikujt e tabelës, pasi nuk ka paraqitur skedën teknike kërkuar në kriter për markat e ofruara. Operatori ka ofruar nga 3 marka për çdo pajisje duke mos paraqitur skeda teknike përkatëse, mbi bazën e të cilës të shihet përputhshmëria me specifikimet teknike të kërkuara në DST nga autoriteti kontraktor.

Komisioni i Prokurimi Publik thekson, se për sa kohë autoriteti kontraktor përcakton specifikimet teknike dhe kriteret në funksion të tyre për mallrat e kërkuara, ato duhet të përmbushen nga operatorët ekonomikë, me qëllim që të sigurohet se pajisjet e ofruara përmbushin të gjitha parametrat e kërkuara në DST.

Operatori ekonomik është palë e interesuar në përmbushje të të gjitha kërkesave të DST me qëllim fitimin e kontratës, ndaj ofertimi i pajisjeve në përputhje me specifikimet teknike është i rëndësishëm.

Komisioni thekson, se është barrë e operatorit ekonomik ofertues në procedurën e prokurimit objekt-shqyrtimi, të vërtetojë se me pajisjet e ofertuara, në rastin konkret me paraqitjen e skedave teknike, përmbush specifikimet teknike të kërkuara në DST. Jo pa qëllim AK kërkon në kriterin 2.3.2 skeda teknike, paraqitja e të cilave ndihmon autoritetin kontraktor në vlerësimet dhe vlefshmërinë e ofertave paraqitur nga operatorët ekonomikë.

Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se autoriteti kontraktor në rastin konkret, vlerësimin e dokumentacionit të ofertuesit e ka bërë jo në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet standarde të tenderit.

Për sa referuar pretendimet e ankimesit qëndrojnë.

III.2. Lidhur me ankesën e operatorit ekonomik ankimues "PC STORE" SHPK ku ngre pretendime për mospërmbushje të kriterëve për kualifikim nga operatori ekonomik "Blueprint Technologies" SHPK, me argumente si vijon:

*[...] OE Blueprint, në këtë procedurë tenderi, **dyshojmë që** nuk ka zbatuar një sërë kërkesash dhe kriteresh, detyruese nga legjislacioni i prokurimit publik dhe të kërkuara në DST. Konkretisht, dyshojmë që nuk ka plotësuar sic duhet Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit. Referuar kërkesave për kualifikim, në DST, rezulton se AK ka kërkuar: "2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT 1. Ofertuesi duhet të paraqesë: a. Formularin*

Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8” dhe ka bashkëlidhur në DST edhe formatin standart se si duhet të plotësohet Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit

Duke u nisur nga fakti se OE Blueprint nuk ka eksperiencë të gjatë në prokurimet publike dhe konkretisht në prokurimet publike të realizuara pas hyrjes në fuqi të ligjit 162/2020 dhe akteve nënligjore në zbatim të tij, dyshojmë që nuk ka plotësuar në mënyrën e duhur dhe nuk ka deklaruar të gjitha të dhënat që kërkohen në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit.

Në këtë rast, kemi dyshimin e arsyeshëm që OE Blueprint nuk ka plotësuar sic duhet Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, për sa i përket kritereve për skualifikim, deklaratave, deklarimit të punonjësve dhe makinerive, etj. [...]

III.2.1. Autoriteti kontraktor ka paraqitur në SPE shtojcën 8,
Shtojca 8 (Shtojcë për tu paraqitur nga operatori ekonomik)

FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT

III.2.2 Në pikat 1 dhe 2 të nenit 82 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” përcaktohet se: “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, **autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji.** Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik. Kur autoriteti ose enti kontraktor mund t'i marrë dokumentet mbështetëse duke u futur direkt në një bazë të aksesueshme të dhënash shtetërore, në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit përcaktohet edhe informacioni që kërkohet për këtë qëllim, siç është adresa në internet e bazës të të dhënave, çdo e dhënë identifikimi dhe, sipas rastit, në deklaratën e nevojshme për dhënien e pëlqimit. Operatorët ekonomikë mund të përdorin një formular vetëdeklarimi që është përdorur gjatë një procedure prokurimi të mëparshme, nëse informacioni që ajo përmban vazhdon të jetë i saktë dhe i vlefshëm.

2. Në çdo kohë gjatë procedurës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë ofertuesve dhe kandidatëve sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, kur kjo është e nevojshme për të garantuar zbatimin korrekt të procedurës.

Ndërsa në nenin 92/3 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” përcaktohet se: “3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji...”.

III.2.3. Neni 48 pika 3 “Kushtet formale të ankesës” të Vendimit Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”,

3. Ankesa, sipas rastit, mund të shoqërohet edhe me:

a. provat dokumentare, të cilat ankimuesi kërkon të shqyrtohen nga Komisioni i Prokurimit Publik;

b. kërkesën për përjashtimin e ndonjë anëtari të Komisionit të Prokurimit Publik për shkak të konfliktit të interesit, nëse ankimuesi ka dijeni paraprakisht për shkakun;

c. kërkesën për ekspertizë të posaçme, kur kjo çmohet e nevojshme për zgjidhjen e çështjes.

III.2.4 Referuar dokumentacionit ngarkuar në SPE të operatorit ekonomik “INSTANT.AL” SHPK, rezulton, se në përmbushje të Shtojcës 8, FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT operatori ka paraqitur në SPE si pjesë të ofertë së tij dokumentin: *Shtojca*, i cili përmban shtojcat 1,2,4 dhe 8 të plotësuara, si dhe firmosur e vulosur nga administratori i shoqërisë.

III.2.5. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se është në drejtë të operatorëve ekonomikë të paraqesin pretendime mbi kundërshtimin e vendimit të autoritetit kontraktor për kualifikimin e ofertës së operatorëve të tjerë ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit, duke justifikuar kështu interesin e tyre të ligjshëm, por ndërkohë, operatorët ekonomikë nuk mund të parashtrajnë pretendime a-priori, duke iu referuar të gjitha kritereve të veçanta të kualifikimit, duke mos indentifikuar asnjë element konkret brenda kritereve të veçanta të kualifikimit, si edhe duke mos dhënë asnjë provë apo argument se ku mbështet pretendimet e tij. Vetë Kodi i Procedurave Administrative ka parashikuar në nenin 82 pika 1 të tij, se “Në procedurat administrative, të filluara me kërkesë të palës që inicion procedurën, barra e provës për faktet e pretenduara bie mbi këtë palë, pavarësisht nga detyrimi i organit publik për të vënë në dispozicion të palëve, provat e zotëruara prej saj”.

Një ndër parimet kryesore të së drejtës është ai se “*onus probandi incumbit actori*”, se barra e provës bie mbi ankuesin. Gjithashtu, KPP gjykon, se kuadri ligjor në fuqi, ka parashikuar të gjithë elementët proceduralë, përmes të cilave garantohet e drejta e informimit të operatorëve ekonomikë në kuadër të zhvillimit të procedurave të prokurimit publik.

III.2.6. Sa më sipër, KPP gjykon, se për të mbështetur pretendimet e tij, ankimuesi duhet të kishte shoqëruar pretendimet e tij me prova, indicje dhe argumente ose dokumentacionin përkatës, në bazë të të cilave do të shqyrtohej kjo ankesë, dhe jo me dyshime të pabazuara në prova konkrete. Akoma më tej referuar ankesës ku ankimuesi ngre pretendime se:

[...] OE Blueprint, në këtë procedurë tenderi, dyshojmë që OE Blueprint nuk ka plotësuar sic duhet Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, për sa i përket kritereve për skualifikim, deklaratave, deklaratimit të punonjësve dhe makinerive, etj. [...], Komisioni referuar DST vëren, se AK nuk ka përcaktuar kritere kualifikuese në lidhje me disponim të makinerive apo personel të kualifikuar punonjësish, çka tregon se ankimuesi ngre pretendime apriori e të pabazuara edhe në DST.

Vlen të ritheksojmë, se Komisioni i Prokurimit Publik është organi më i lartë administrativ, i cili shqyrton ankesat mbi vendimet e marra nga KVO e autoritetit kontraktor, por ligjvënësi qartazi i ka ndarë detyrat dhe kompetencat e këtyre dy organeve. Pra, KPP nuk mund të marrë tagrin e KVO-së dhe të rivlerësojë në themel procedurën e prokurimit publik.

Operatori ekonomik ka detyrimin që ta bëjë të identifikueshëm pretendimin e tij mbi shkeljen e pretenduar, pra të evidentojë qartë dhe saktë se ku e bazon pretendimin e tij për mospërmbushjen e kriterit/kritereve nga ana e operatorëve ekonomikë të tjerë dhe jo të

shprehë vetëm mosplotësimin e tyre në mënyrë të paargumentuar. Theksojmë, se mospërmbushja e kriterit mund të vijë për shkaqe të ndryshme, siç janë mosparaqitja e një dokumenti të kërkuar, ose problematika që mund të prekin dokumentin etj. Është barrë e operatorit ekonomik që të përcaktojë, se në cilin fakt apo rrethanë e mbështet pretendimin e tij për mospërmbushje kriteri/kriteresh.

III.2.7. Komisioni i Prokurimit Publik, thekson dallimin e qartë në gjykimin e tij, ndërmjet një pretendimi të një operatori ekonomik që ngre shqetësim mbi vlerësimin hipotetikusht të gabuar të ofertës së vetë atij nga ana e autoritetit kontraktor, nga njëra anë, dhe pretendimit/premendimeve të këtij operatori apo të cilitdo operatori pjesëmarrës në një procedurë prokurimi publik ndaj mënyrës së vlerësimit të autoritetit kontraktor për operatorët e tjerë konkurrentë në këtë procedurë, nga ana tjetër. Në rastin e parë, kur interesi është absolut dhe i drejtpërdrejtë, barra e provës për të argumentuar shkeljet e pretenduara të autoritetit, ndonëse sërish qëndron mbi ankimesin, në gjykimin e KPP është arsyeshmërisht më e lehtë. KPP e mirëkupton pozitën e operatorit dhe në kuptim të misionit të tij për të siguruar eficientësi të procedurave të prokurimit publik, përmes nxitjes së pjesëmarrjes së operatorëve ekonomikë, vlerëson se duhet të adoptojë një qëndrim proaktiv, në krahasim të operatorit ankimes. Në rastin e dytë, kur operatori pjesëmarrës në një procedurë ankohet në lidhje me ofertat e operatorëve konkurrentë, pesha specifike e barrës për të provuar paligjshmërinë hipotetike të këtyre të fundit është e plotë dhe qëndron mbi kurrizin e pretenduesit, ndërkohë që KPP adapton një pozicion re-aktiv, në pritje të argumenteve të plota provuese, se përse vlerësimi i autoritetit kontraktor ka qenë i gabuar, sipas ankimesit.

Referuar arsytimit më sipër, pretendimet e operatorit ekonomik ankimes nuk do të merren në shqyrtim.

III.3. Lidhur me pretendimet e tjera të ankimesit “PC STORE”SHPK mbi skualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “Blueprint Technologies” SHPK, nuk do të merren në shqyrtim për ekonomi të procedurës administrative, pasi referuar gjykimin më sipër, gjendja faktike dhe juridike e operatorit ekonomik “Blueprint Technologies” SHPK, do të ndryshojë duke u skualifikuar, e rrjedhimisht interesi i ankimesit u përmbush.

III.4. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik në pikën 1 të ankesës për mospërmbushje të kriterëve për kualifikim nga operatorit ekonomik “INSTANT.AL” SHPK me argumente si vijon:

“Shprehim dyshimet tona mbi dorëzimin fizikusht të dokumentave të tenderit në AK Bashkia Shijak. Referuar VKM Nr.285 datë 19/05/2021 “Rregullat e Prokurimit Publik”, ku parashikohet se: “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike . Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin. Autoriteti/enti kontraktor pranon një dokument të lëshuar nga i njëjti institucion ose palë e tretë dhe që ka të njëjtin informacion me atë të paraqitur në procedurën e zhvilluar në

mënyrë elektronike.” Duhet që OE INSTANT.AL të ketë dorëzuar dokumentacionin shoqërues të ofertës që është i ngarkuar në SPE dhe dokumentet e përmendura në formular përmbledhës të vetëdeklarimit, origjinale ose të noterizuara, në AK Bashkia Shijak, pas klasifikimit dhe përpara publikimit të njoftimi paraprak të fituesit.

Në fakt, rezulton se njoftimi i klasifikimit, publikimi i renditjes së OE pjesëmarrës në procedurën e prokurimit objekt i këtij ankimi, është kryer në datën 22/01/2024 ora 11:58. Ndërkohë njoftimi paraprak i fituesit dhe fillimi i afatit të ankimit, është në datën 23/01/2024 ora 10:44.

Pra në më pak se 24 orë, OE INSTANT.AL ka marrë dijeni për renditjen e ofertave të OE, AK i ka kërkuar dokumentacionin sipas nenit 26 të VKM, OE INSTANT.AL ka përgatitur dokumentacionin origjinal ose të noterizuar, e ka dorëzuar në AK dhe AK e ka vlerësuar si të rregullt dokumentacionin e dorëzuar fizikisht. E gjithë kjo procedurë në më pak se 24 orë!!

Prandaj, duke u nisur nga konstatimi i mësipërm, kemi dyshime të arsyeshme bazuar në indicje reale, që OE INSTANT.AL nuk ka dorëzuar në AK Bashkia Shijak dokumentacionin sipas VKM Nr.285 datë 19/05/2021 “Rregullat e Prokurimit Publik”, ku parashikohet se: “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike . Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin. Autoriteti/enti kontraktor pranon një dokument të lëshuar nga i njëjti institucion ose palë e tretë dhe që ka të njëjtin informacion me atë të paraqitur në procedurën e zhvilluar në mënyrë elektronike.””

III.4.1. Neni 2 “Qëllimi i ligjit” 162/2021 “Për prokurimin publik” parashikon se:

Qëllim i këtij ligji është:

- a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;
- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;
- dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.

III.4.2. Neni 3 “Parime të përgjithshme“ i ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikon shprehimisht se:

1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale.
2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar.

3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.

III.4.3. Neni 21 “Autoriteti ose enti kontraktor” i Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikon shprehimisht se:

1. Autoriteti ose enti kontraktor është përgjegjës për prokurimin në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, duke garantuar respektimin e parimeve të trajtimit të barabartë, transparencës, konkurrencës dhe mosdiskriminimit, të parashikuara në këtë ligj. Në kuptim të kësaj pike, autoriteti ose enti 7 kontraktor ka detyrimin të mirëplanifikojë në cilësi dhe në kohë fondet publike e nevojat e tij dhe të prokurojë e të zbatojë kontratën në përputhje me legjislacionin në fuqi.

III.4.4. Neni 118, “Vendimet e Komisionit të Prokurimit Publik” i Ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikon shprehimisht se: “1. Komisioni i Prokurimit Publik, në çdo kohë pas marrjes së ankesës dhe para lidhjes së kontratës, kur nuk vendos pezullimin, mund ta lejojë autoritetin ose entin kontraktor, me anë të një vendimi të ndërmjetëm deri në marrjen e një vendimi përfundimtar, të vazhdojë procedurën e prokurimit nëse pezullimi dëmton tërthorazi interesin publik, autoritetin ose entin kontraktor ose ofertuesit.

2. Përpara lidhjes së kontratës, Komisioni i Prokurimit Publik ka të drejtë:

a) të refuzojë ankesën, për shkak të mosplotësisht të elementeve të domosdoshme për shqyrtimin e saj, sipas parashikimeve të nenit 111 të këtij ligji;

b) të pranojë ankesën dhe të urdhërojë autoritetin ose entin kontraktor të anulojë plotësisht ose pjesërisht një veprim ose vendim, të nxjerrë në kundërshtim me ligjin;

c) të refuzojë ankesën dhe të lejojë autoritetin ose entin kontraktor të vazhdojë procedurën e prokurimit, kur gjykon se nuk ka shkelje të dispozitave ligjore;

ç) të nxjerrë vendim deklarativ për mbylljen e çështjes, sipas parashikimeve të pikave 2 dhe 3 të nenit 115 të këtij ligji;

d) të refuzojë ankesën, e cila ka si objekt kundërshtimin e një vendimi të dhënë nga Komisioni i Prokurimit Publik, në rast të një ankese tjetër që i përket të njëjtës procedurë, të paraqitur nga i njëjti operator ekonomik”.

III.4.5. Referuar Nenin 26, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, ku parashikohet se: “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.”

III.4.6. Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon, se autoriteti kontraktues është organi përgjegjës për prokurimin e fondeve publike, në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore në fuqi. Në këtë kuadër, hartimi i dokumenteve të tenderit dhe zhvillimi i procedurës së prokurimit, është lënë nën përgjegjësinë e autoritetit kontraktor, gjithnjë në përputhje e përpjesëtim me objektin e natyrën e kontratës objekt-prokurimi, si dhe aktet ligjore dhe

nënligjore në fuqi që lidhen në mënyrë të drejtpërdrejtë me kriteret e vendosura në dokumentet e tenderit dhe hapat që duhet të ndiqen për përzgjedhjen e ofertës më të mirë, në kuptim të këtij ligji, vlerësimin e ofertave .

Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon të ndalet fillimisht në ligjshmërinë e veprimeve të autoritetit kontraktor, për sa kohë që objekti i ankesës ka lidhje me veprimet e ndërmarra kryesisht nga autoritetit kontraktor gjatë ndjekjes së të gjitha hapave të procedurës së prokurimit objekt-ankimi si edhe veprimet e operatorit ekonomik pas marrjes dijeni të renditjes dhe vlerësimit të ofertave.

Me qëllim vijimin e gjykimit të ankesës pranë KPP-së në përputhje me nenin 115 të LPP-së, referuar nenit 26/6 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021, *“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”* i ndryshuar, ku parashikohet se: *“Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.”*, Komisioni i Prokurimit Publik, me shkresën me nr. 182/5 Prot., datë 05.02.2024, me objekt: *Mbi detyrimin e autoritetit kontraktor për dhënie informacioni KPP-së lidhur me ankesën e operatorit ekonomik “INSTANT.AL” SHPK*, i kërkoi Autoritetit Kontraktor të dorëzojë pranë KPP-së kopje të dokumentacionit të plotë të ofertës të dorëzuar nga operatori ekonomik “INSTANT.AL” SHPK.

Në përgjigje të shkresës sipërcituar, Autoriteti kontraktor me shkresën nr. 577/1 prot., datë 08.02.2024, protokolluar me tonën me nr. 182/7, datë 12.02.2024, ka paraqitur pranë Komisionit të Prokurimit Publik *“Informacion”*, duke përcjellë dokumentacionin e dorëzuar nga operatori ekonomik “INSTANT.AL” SHPK.

Komisioni i Prokurimit Publik, nga verifikimet e kryera në Informacionin e përcjellë konstatoi se: Operatori ekonomik, “INSTANT.AL” SHPK në përmbushje të nenit 26 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 *“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”* i ndryshuar, ka dorëzuar pranë autoritetit kontraktor, dokumentet provuese të ofertës së tij të shoqëruara me shkresën me objekt: ”Listë dorëzimi dokumentacioni”, datë 24.01.2024, protokolluar pranë AK Bashkia Shijak me Nr. 389/1 Prot., datë 24.01.2024.

III.4.7. Komisioni referuar pretendimeve të ankimuesit, Informacionit të autoritetit kontraktor si edhe publikimit në Sistemin e Prokurimeve Elektronike të procedurës së prokurimit vëren, se autoriteti kontraktor ka kryer vlerësimin e ofertave më datë 22.01.2024, ora 12.20 pasdite dhe po në të njëjtën datë dhe orë ka krijuar Njoftimin e Fituesit Praprak, duke e përfunduar më datë 23.01.2024, ora 10.44 paradite. Gjithashtu, referuar Informacionit të autoritetit kontraktor rezulton, se operatori ekonomik fitues, në përmbushje të nenit 26 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar, ka dorëzuar pranë autoritetit kontraktor më datë 24.01.2024, dokumentacionin provues në formë shkresore, të ofertës së tij paraqitur në SPE

Komisioni i Prokurimit Publik thekson faktin, se përcaktimi i procedurave të prokurimit, rregullat në ndjekjen e fazave të saj dhe respektimit të afateve të caktuara procedurale në LLP dhe Rregullat e Prokurimit Publik, në lidhje me zhvillimin e procedurës së prokurimit, duke

filluar nga afati i shqyrtimit të ofertave, vlerësimit të tyre, dorëzimit të dokumentacionit të ofertës së kualifikuar e para në renditje, njoftimit të fituesit, afatet e ankimimit etj, përfaqësojnë garanci dhe siguri juridike për palët e interesuara.

Parimi i ligjshmërisë është ndër parimet kryesore të veprimitarisë së organeve të administratës publike. Gjithashtu, ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurave të prokurimit, parashikuar nga *lex specialis* LPP, në nenin 2 të tij, janë ato të mosdiskriminimit, transparencës dhe barazisë. Tërësia e elementeve të mësipërme lidhet ngushtësisht me elemente të ligjshmërisë së vendimeve të organeve të administratës publike. Gjithashtu, KPP gjykon, se ligjvënësi ka parashikuar afate strikte kohore për zhvillimin e procedurave të prokurimit në përgjithësi dhe në veçantit të vlerësimit dhe dorëzimit të ofertave dhe paraqitjes së dokumentacionit provues nga operatori i renditur i pari, përcaktuar në Nenin 26, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar, ku parashikohet se: “*Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.*”

Në interpretim të sa më sipër KPP gjykon, se autoriteti kontraktor ka detyrimin t’i kërkojë ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin. Në rastin konkret KPP vëren, se momenti procedural i kërimit të dokumenteve origjinale dhe verifikimi i tyre nga ana e autoritetit kontraktor për operatorin ekonomik “INSTANT.AL” SHPK, duhet të ishte data 22.01.2024, datë në të cilën referuar dhe sistemit prokurimeve elektronike, rezulton të jetë përmbyllur dhe procesi i vlerësimit të ofertave nga ana komisionit të vlerësimit të ofertave, pasi dhe në udhëzimin nr. 07, datë 30.07.2021, “*Për mënyrën e zhvillimit të procedurave të prokurimit me mjete elektronike*”, parashikohet se: *Pas përfundimit të procesit të vlerësimit nga të gjithë anëtarët e KVO për të gjitha ofertat e dorëzuara nga operatorët ekonomikë, anëtari i autorizuar i njësisë së prokurimit duhet të bëjë në sistem mbylljen e fazës së vlerësimit të ofertave në sistem. Në këtë moment sistemi iu dërgon në mënyrë elektronike automatikisht njoftimin mbi klasifikimin e gjithë operatorëve ekonomikë pjesëmarrës.*

III.4.8. Pra nga sa më sipër rezulton, se autoriteti kontraktor nuk ka ndjekur hapat proceduralë të parashikuar dhe në udhëzimin e sipërcituar, ku thuhet se pas *përfundimit të procesit të vlerësimit nga të gjithë anëtarët e KVO për të gjitha ofertat e dorëzuara nga operatorët ekonomikë, sistemi iu dërgon në mënyrë elektronike automatikisht njoftimin mbi klasifikimin e gjithë operatorëve ekonomikë pjesëmarrës*, dhe pas këtij veprimi procedural autoriteti duhej të kryente veprimet procedurale që parashikon neni 26 pika 6 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*” i ndryshuar, ku thuhet se *[...] Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni*

[...] Referuar bazës ligjore të sipërcituar KPP gjykon, se ligjvënësi ka përcaktuar një procedurë të caktuar për t’u ndjekur nga ana e autoriteteve kontraktore. Në rastin konkret, autoriteti kontraktor nuk ka respektuar hapat proceduralë të parashikuar nga ligji në lidhje me kërkimin e dokumentacionit, ofertuesit të kualifikuar i pari, e më pas të vijonte me njoftimin e fituesit paraprak.

KPP i tërheq vëmendjen autoritetit kontraktor, për mosrespektim të dispozitave ligjore në fuqi, lidhur me momentin procedural të verifikimit të dokumentacionit origjinal në shkelje të afateve ligjore.

Për sa referuar kronologjisë së fakteve, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se autoriteti kontraktor nuk ka respektuar etapat e procedurës së prokurimit, duke publikuar njoftimin e fituesit paraprak përpara dorëzimit dhe vlerësimit të dokumentacionit provues të ofertës së renditur e para në vlerësimin e kryer nga KVO.

Në nenin 118, pika 2, gërma “b” të Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, sipas të cilit: “Përpara lidhjes së kontratës, Komisioni i Prokurimit Publik ka të drejtë: të pranojë ankesën dhe të urdhërojë autoritetin ose entin kontraktor të anulojë plotësisht ose pjesërisht një veprim ose vendim, të nxjerrë në kundërshtim me ligjin; nenit 98, pika 1, gërma “d” të këtij ligji”, përcaktohet shprehimisht: “Autoriteti ose enti kontraktor anulon procedurën e prokurimit në rastet kur Komisioni i Prokurimit Publik vendos anulimin sipas parashikimeve në këtë ligj”. Në nenin 45, pika 1 gërma “b” të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 766/2021, datë 13.10.2021, “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, ku parashikohet se: “[...]Komisioni i Prokurimit Publik në kuadër të veprimtarisë së shqyrtimit të ankesave para lidhjes së kontratës procedon me: b) Vendim për pranimin e ankesës dhe urdhërimin e autoritetit/entit kontraktor, që të anulojë plotësisht ose pjesërisht një veprim ose vendim, të nxjerrë në kundërshtim me ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” [...]”.

Në kushtet kur autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me frymën e ligjit të prokurimit publik, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se procedura e prokurimit duhet të anulohet dhe në ripublikim të saj, autoriteti kontraktor të ketë parasysh konstatimet e këtij vendimi në zhvillimin e procedurë së prokurimit.

Për sa referuar më sipër pretendimet e ankimuesit qëndrojnë pjesërisht.

III.5. Lidhur me ankesën e operatorit ekonomik ankimues “PC STORE” SHPK, ku ngre pretendime për mospërbushje të kriterit 2.3.2 nga operatori ekonomik “INSTANT.AL” SHPK, me argumente si vijon:

Dyshojmë se OE Blueprint Technologies ShPK nuk plotëson kërkesën 2.3.2 Operatorët ekonomikë ofertues duhet të plotësojnë dhe të dorëzojnë së bashku me dokumentet e tjera, skedën teknike për artikujt objekt - prokurimi, sipas tabelës së mëposhtme:

<i>A</i>	<i>B</i>	<i>C</i>
<i>Nr.</i>	<i>Emërtimi i artikullit</i>	<i>Kompania prodhuese</i>
<i>1</i>	<i>KOMPJUTER All-In-One (AiO) 23"</i>	

2	KOMPJUTER All-in-One (AiO) 24"	
3	PRINTER B&W Advanced	
4	FOTOKOPJE Multifunction Color Copy Machine A4	

Pra duke u bazuar në pikën 2.3.2, OE duhet të dorëzojnë skedën teknike (katalogët) për produktet sipas tabelës së mësipërme, kemi informacione dhe dyshime të arsyeshme bazuar në indicje reale, që OE Blueprint Technologies nuk plotëson pikën 2.3.2 në DST e procedurës objekt të këtij ankimi, pasi nuk ka dorëzuar në SPE skedat teknike për produktet KOMPJUTER All-In-One (AiO) 23", KOMPJUTER All-in-One (AiO) 24", PRINTER B&W Advanced, FOTOKOPJE Multifunction Color Copy Machine A4

III.5.1 Autoriteti kontraktor ka publikuar në SPE shtojcën 5 dhe shtojcën 7, të modifikuara si vijon: **Shtojca 5.**

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Përshkrimi i Specifikimeve Teknike të mallrave objekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve plotësisht të justifikuara, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh kriteret e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi.

SHËNIM: Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent".

Skicimet, parametrat teknik etj:

Specifikimi i Materialeve:

Përshkrimi i të dhënave teknike të mallrave objekt prokurimi të përshkruara sa më saktë dhe në mënyrë të plotë, duke krijuar kushte për konkurrim të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve. Kur është e mundur, specifikimet teknike duhet të përcaktohen në mënyrë të tillë që të kuptohen nga personat me aftësi të kufizuara.

Keto kerkesa jane hartuar ne perputhje me parashikimet e dispozitave ligjore/nenligjore

1.KOMPJUTER All-In-One (AiO) 23"

KARAKTERISTIKA MINIMALE TEKNIKE	
Pikët Min. për Procesorin sipas: cpubenchmark.net Min Proc. Rating According to: cpubenchmark.net:	11,000 Pikë
"Chipset":	Intel ose Ekuivalent
"RAM":	16 GB, min. DDR4 2666 MHz

<i>Madhësia e Solid-state Drive "SSD Size":</i>	<i>512 GB SSD</i>
<i>"Graphics":</i>	<i>Integrated HD Graphics</i>
<i>Ekrani "Display":</i>	<i>23" Min. FHD (1920x1080) LED Backlight, Anti-Glare</i>
<i>Web Camera":</i>	<i>Min. FHD Camera</i>
<i>"Speakers":</i>	<i>Internal Stereo Speakers</i>
<i>Ushqimi "Power Supply":</i>	<i>220 V AC, 50 Hz</i>
KOMUNIKIMI & MENAXHIMI	
<i>Portat e Komunikimit "Ports":</i>	<i>Min. (5) USB nga të cilat min. (2) USB 3.0; (1) RJ-45; (1) DP/HDMI Min. (1/1)Headphone/Microphone Jack ose (1) Combo Jack; (1) Integrated Mic.;</i>
<i>Rrjeti "Networking":</i>	<i>10/100/1000 Mbps LAN (RJ-45); Wireless 802.11ac (Kompatibël me 802.11b/g/n); Bluetooth min. V4.1</i>
<i>Sistemi i Operimit "Preinstalled Licensed O. S.":</i>	<i>OEM Windows 10 64-bit Professional</i>
<i>Tastiera "Keyboard":</i>	<i>Standart Keyboard QWERTY</i>
<i>"Pointing Device":</i>	<i>Standart Optical Mouse</i>
<i>Siguria "Security":</i>	<i>Embedded Security TPM 2.0</i>
AKSESORËT	
<i>Kabëll "Power Cord":</i>	<i>Po, European</i>
<i>"Recover":</i>	<i>Recover Partition</i>
<i>Të tjera:</i>	<i>Energy Star</i>
GARANCIA	
<i>Periodha e Mbulimit të Garancisë "Warranty":</i>	<i>3 Vjet</i>

2.KOMPJUTER All-in-One (AiO) 24"

KARAKTERISTIKA MINIMALE TEKNIKE	
<i>Pikët Min. për Procesorin sipas: cpubenchmark.net Min Proc. Rating According to: cpubenchmark.net:</i>	<i>15,000 Pikë</i>
<i>"Chipset":</i>	<i>Intel ose Ekuivalent</i>
<i>"RAM":</i>	<i>16 GB, min. DDR4 2666 MHz</i>
<i>Madhësia e Solid-state Drive "SSD Size":</i>	<i>512 GB SSD</i>
<i>"Graphics":</i>	<i>Integrated HD Graphics</i>
<i>Ekrani "Display":</i>	<i>24" Min. FHD (1920x1080) LED Backlight, Anti-Glare</i>
<i>"Web Camera":</i>	<i>Min. FHD Camera</i>
<i>"Speakers":</i>	<i>Internal Stereo Speakers</i>
<i>Ushqimi "Power Supply":</i>	<i>220 V AC, 50 Hz</i>
KOMUNIKIMI & MENAXHIMI	
<i>Portat e Komunikimit "Ports":</i>	<i>Min. (5) USB nga të cilat min. (2) USB 3.0; (1) RJ-45; (1) DP/HDMI Min. (1/1)Headphone/Microphone Jack</i>

	<i>ose (1) Combo Jack; (1) Integrated Mic.;</i>
<i>Rrjeti "Networking":</i>	<i>10/100/1000 Mbps LAN (RJ-45); Wireless 802.11ac (Kompatibël me 802.11b/g/n); Bluetooth min. V4.1</i>
<i>Sistemi i Operimit "Preinstalled Licensed O. S.":</i>	<i>OEM Windows 10 64-bit Professional</i>
<i>Tastiera "Keyboard":</i>	<i>Standart Keyboard QWERTY</i>
<i>"Pointing Device":</i>	<i>Standart Optical Mouse</i>
<i>Siguria "Security":</i>	<i>Embedded Security TPM 2.0</i>
AKSESORËT	
<i>Kabëll "Power Cord":</i>	<i>Po, European</i>
<i>"Recover":</i>	<i>Recover Partition</i>
<i>Të tjera:</i>	<i>Energy Star</i>
GARANCIA	
<i>Periudha e Mbulimit të Garancisë "Warranty":</i>	<i>3 Vjet</i>

3. PRINTER B&W Advanced

KARAKTERISTIKA MINIMALE TEKNIKE	
<i>Shpejtësia e Printimit "Print Speed" A4:</i>	<i>≥ 45 ppm</i>
<i>Cikli Mujor i Punës "Monthly Duty Cycle":</i>	<i>60 000 Faqe</i>
<i>Teknologjia "Technology":</i>	<i>Laser</i>
<i>Rezolucioni i Printimit Minimal "Print Quality":</i>	<i>1200x1200 dpi</i>
<i>Kapaciteti në Hyrje "Input Capacity"</i>	<i>500 Fletë</i>
<i>Pesha Specifike e Letrës "Media Sizes":</i>	<i>60-120 g/m²</i>
<i>Formati i Letrës "Media format":</i>	<i>A4/A5/Envelope</i>
<i>Aftësia e Printimit Duplex:</i>	<i>Po</i>
<i>Memorja "Memory":</i>	<i>≥ 256 MB</i>
<i>"Toner":</i>	<i>Shoqëruar me Starter Kit</i>
KOMUNIKIMI & MENAXHIMI	
<i>Porta e Komunikimit "Interface":</i>	<i>High Speed USB 2.0</i>
<i>"Ethernet":</i>	<i>Po</i>
AKSESORËT	
<i>Kabëll "Power Cord":</i>	<i>Po, European</i>
<i>Software/Drivers CD:</i>	<i>Po</i>
<i>Kabëll USB:</i>	<i>Po</i>
GARANCIA	
<i>Periudha e Mbulimit të Garancisë "Warranty":</i>	<i>2 Vjet</i>
<i>Pjesët e konsumueshme janë drum-i dhe toneri.</i>	

4.FOTOKOPJE Multifunction Color Copy Machine A4

KARAKTERISTIKA MINIMALE TEKNIKE	
<i>"Model":</i>	<i>Copier, Printer, Scanner</i>
<i>Shpejtësia "Copy/Print Speed for A4 B&W":</i>	<i>≥ 20 ppm</i>
<i>Cikli Mujor i Punës "Monthly Duty Cycle":</i>	<i>≥ 30 000 Faqe</i>
<i>Teknologjia "Technology":</i>	<i>Laser Color/B&W</i>
<i>Zvogëlim/Zmadhim "Reduction/Enlargement":</i>	<i>25% - 400%</i>

Vendosja e Letrës “Document Feeder”:	ADF
Sirtaret per Letrën “Paper Trays”:	min 1
Kapaciteti në Hyrje “Input Capacity min.”:	150 Fletë (jo Bypass)
Kapaciteti në Dalje “Output Capacity min. Standard”:	100 Fletë
Kopjim/Printim në të dy Faqet “Duplex Copying/Print.”:	Nuk Specifikohet
Formati i Letrës “Media Sizes”:	A4
Memorja “Memory”:	≥ 256 MB
“Hard Disk”:	Nuk Specifikohet
Shpejtësia e Skanimit “Scan Speed”:	Nuk Specifikohet
Rezolucioni i Skanimit “Scan Resolution”:	600 dpi
Ushqimi “Power Supply”:	220 V AC, 50 Hz
“Toner”:	Shoqëruar me Starter Kit
KOMUNIKIMI & MENAXHIMI	
Porta e Komunikimit “Interface”:	High Speed USB 2.0
“Ethernet”:	Po
AKSESORËT	
Kabëll “Power Cord”:	Po, European
Software/Drivers CD:	Po
GARANCIA	
Periudha e Mbulimit të Garancisë “Warranty”:	1 Vit, 90 000 Kopje *
* Kush të arrihet më parë	
Pjesët e konsumueshme janë drum-i dhe toneri.	

Shtojca 7 KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT, 2.3 Kapacitet teknik,

2.3.2 Operatorët ekonomikë ofertues duhet të plotësojnë dhe të dorëzojnë së bashku me dokumentet e tjera, **skedën teknike** për artikujt objekt prokurimi, sipas tabelës së mëposhtme:

A	B	C
Nr.	Emërtimi i artikullit	Kompania prodhuese
1	KOMPJUTER All-In-One (AiO) 23"	
2	KOMPJUTER All-in-One (AiO) 24"	
3	PRINTER B&W Advanced	
4	FOTOKOPJE Multifunction Color Copy Machine A4	

III.5.2 Në nenin 2 “Qëllimi” të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet shprehimisht se: “Qëllim i këtij ligji është:

- a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;

d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik

dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.”

Ndërkohe në nenin 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet shprehimisht se:

“1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale.

2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar.

3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.”

III.5.3. Në nenin 36 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” parashikohet shprehimisht se:

“Specifikimet teknike, siç përcaktohen në nenin 4 të këtij ligji, duhet të përshkruhen në dokumentet e tenderit. Në specifikimet teknike përcaktohen qartë karakteristikat e punëve, shërbimit ose furnizimit që do të prokurohet.

Këto karakteristika mund të lidhen edhe me procesin specifik ose metodën e prodhimit ose ofrimit të punëve, furnizimeve ose shërbimeve të kërkuara ose me një proces specifik për një fazë tjetër të ciklit jetësor edhe kur këta faktorë nuk përbëjnë përmbajtjen e saj thelbësore nëse ato janë të lidhura me objektin e kontratës dhe proporcionale me vlerën dhe objektivat e saj.

Në specifikimet teknike mund të specifikohet edhe nëse do të jetë i nevojshëm transferimi i të drejtave të pronësisë intelektuale.

Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve të justifikuara plotësisht, hartohen në mënyrë të tillë që të marrin në konsideratë kriteret e aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuar ose projektimit për të gjithë përdoruesit, sipas kërkesave në legjislacionin në fuqi.

2. Specifikimet teknike duhet të mundësojnë trajtim të barabartë për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit dhe të mos shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik.

3. Specifikimet teknike duhet të përshkruajnë qartë kërkesat e autoritetit ose entit kontraktor, duke iu referuar:

a) kërkesave funksionale ose të performancës, përfshirë karakteristikat mjedisore, me kusht që parametrat të jenë të saktë në mënyrë që t’u japin mundësi ofertuesve të përcaktojnë objektin e kontratës dhe autoriteteve ose enteve kontraktore të japin kontratën;

b) standardeve kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimeve teknike ndërkombëtare, specifikimeve teknike të përgjithshme, standardeve ndërkombëtare apo sistemeve të tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit. Kur këto nuk ekzistojnë, ato u referohen standardeve kombëtare, miratimeve teknike kombëtare ose specifikimeve teknike kombëtare, që lidhen me projektimin, përlllogaritjen dhe ekzekutimin e punëve ose përdorimin e produkteve;

c) kërkesave në terma funksionalë sipas shkronjës “a”, referuar specifikimeve teknike sipas shkronjës “b” të kësaj pike, si mënyrë që nënkupton pajtueshmëri me kërkesat funksionale;
ç) të dyja metodave të përcaktuara në shkronjat “a” dhe “b” të pikës 3 të këtij neni, për mallra, shërbime ose punë të ndryshme, të përfshira në të njëjtin objekt kontrate. Çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

4. Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të këtij neni. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

5. Në rast se autoriteti ose enti kontraktor përcakton specifikimet teknike në bazë të shkronjës “b” të pikës 3 të këtij neni, nuk mund të refuzojë një ofertë me argumentin se punët, furnizimet apo shërbimet për të cilat është dorëzuar oferta nuk plotësojnë specifikimet teknike, të cilave u referohen, për sa kohë që ofertuesi provon në ofertën e tij me çdo mjet të përshtatshëm që zgjidhjet e propozuara përmbushin kërkesat e përcaktuara në specifikimet teknike në mënyrë ekuivalente.

6. Në rast se autoriteti ose enti kontraktor përcakton specifikimet teknike në bazë të shkronjës “a” të pikës 3 të këtij neni, ai nuk mund të refuzojë një ofertë për punë, mallra apo shërbime, e cila është në përputhje me standardet kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimet teknike ndërkombëtare, specifikimet teknike të përgjithshme, standardet ndërkombëtare apo sistemet e tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit kur këto specifikime teknike përmbushin kriteret funksionale, të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor.”

III.5.4 Në nenin 40 pika 6, “Kërkesa të vecanta për kontratat e mallrave” të Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, citohet:

6. Autoriteti/enti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si:

d) mostra të mallit, kur e gjykon se kjo ka rëndësi për vlerësimin e ofertës teknike. Në këtë rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të argumentojë kërkesën për mostrat. Mostrat duhet të trajtohen si informacion konfidencial tregtar dhe duhet të jenë në kontroll të autoritetit/entit kontraktor. Në rastin e procedurave të zhvilluara me mjete elektronike, autoriteti ose enti kontraktor përcakton qartë procedurën për dorëzimin e mostrave, duke garantuar aksesin e çdo operatori të interesuar si dhe konfidencialitetin për pjesëmarrjen në proces. Mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve pas nënshkrimit të kontratës, me kusht që kontrata në fjalë të mos jetë objekt i shqyrtimit administrativ apo gjyqësor. Në rastin kur procedura e prokurimit anulohet, mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së vendimit përfundimtar të anulimit; dhe/ose

e) fotografitë apo katalogët teknikë; dhe/ose

f) dëshmi për rezultatet e testimeve zyrtare, të lëshuara nga institucione të autorizuar, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike.

III.5.5. Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon, se autoritetet kontraktore në hartimin e specifikimeve teknike dhe kritereve për kualifikim, krahas përshkrimit të saktë të nevojave të këtij të fundit, duhet të kenë në vëmendje faktin se, hartimi i tyre duhet bërë në një mënyrë gjithëpërfshirëse duke krijuar kushte për konkurrim të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve, duke përshkruar sa më saktë dhe në mënyrë të plotë karakteristikat e mallrave/shërbimeve/punëve dhe në përputhshmëri me objektin e kontratës. Për këtë qëllim ligjvënësi ka parashikuar se këto karakteristika mund të lidhen edhe me procesin specifik ose metodën e prodhimit ose ofrimit të punëve, furnizimeve ose shërbimeve të kërkuara ose me një proces specifik për një fazë tjetër të ciklit jetësor edhe kur këta faktorë nuk përbëjnë përmbajtjen e saj thelbësore nëse ato janë të lidhura me objektin e kontratës dhe proporcionale me vlerën dhe objektivat e saj. Ligjvënësi ka parashikuar qartësisht në nenin 36 pika 1 paragrafi 4 të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, se duhet të mundësojnë trajtim të barabartë për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit dhe të mos shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik.

Në respekt të parimit të mësipërm, specifikimet teknike, në asnjë rast nuk duhet të diskriminojnë/përrjashtojnë nga konkurrimi operatorët ekonomikë ofertues dhe/ose prodhuesit qofshin këta kombëtar apo ndërkombëtar.

Autoriteti kontraktor me specifikimet teknike orienton operatorët ekonomikë në përgatitjen e ofertave. Operatorët ekonomikë janë pala e interesur në përmbushjen e specifikimeve teknike me mallrat që ata ofertojnë. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit, me dokumentacionin e dorëzuar, duhet të vërtetojnë, që produkti i ofruar është në përputhje me parametrat dhe specifikimet teknike e kërkuara nga autoriteti kontraktor. Operatorët ekonomikë ofertues marrin përsipër përmbushjen e specifikimeve teknike/ kritereve të përcaktuara në dokumentet e tenderit nga ana e autoriteteve kontraktore, nëpërmjet deklaratave dhe dokumentacionit provues në të cilin duhet të faktojnë përputhshmërinë e dokumentacionit me kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor, në mënyrë që nga ana e këtij të fundit të mund të kryhet me lehtësi e saktësi vlerësimi i mallrave apo shërbimeve të ofertuara nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës, duke përzgjedhur atë ofertues, i cili me dokumentacionin e dorëzuar garanton përputhshmërinë me kriteret e përcaktuara në DT, e rrjedhimisht realizimin me sukses të kontratës objekt - prokurimi.

III.5.6. Komisioni i Prokurimit Publik vëren, se nga shqyrtimi i dokumenteve të tenderit të procedurës objekt - shqyrtimi, autoriteti kontraktor ka kërkuar shprehimisht, që operatorët ekonomikë pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi duhet të paraqesin:

2.3.2 Operatorët ekonomikë ofertues duhet të plotësojnë dhe të dorëzojnë së bashku me dokumentet e tjera, skedën teknike për artikujt objekt - prokurimi, sipas tabelës së mëposhtme:

A	B	C
Nr.	Emërtimi i artikullit	Kompania prodhuese
1	KOMPJUTER All-In-One (AiO) 23"	
2	KOMPJUTER All-in-One (AiO) 24"	

3	<i>PRINTER B&W Advanced</i>	
4	<i>FOTOKOPJE Multifunction Color Copy Machine A4</i>	

Operatori ekonomik “INSTAN.AL”SHPK në dokumentet e ofertës hedhur në SPE ka depozituar dokumentin emërtuar: *Deklarata_tabela*. Referuar këtij dokumenti Komisioni konstatoi, se operatori ka paraqitur në dokument kriterin sipas DST dhe poshte tij ka plotësuar si vijon:

Shoqeria jone deklaron sipas tabelës:

A	B	C
Nr.	Emërtimi i artikullit	Kompania prodhuese
1	<i>KOMPJUTER All-In-One (AiO) 23"</i>	<i>LENOVO</i>
2	<i>KOMPJUTER All-in-One (AiO) 24"</i>	<i>LENOVO</i>
3	<i>PRINTER B&W Advanced</i>	<i>BROTHER</i>
4	<i>FOTOKOPJE Multifunction Color Copy Machine A4</i>	<i>BROTHER</i>

Nënshkruar dhe vulosur nga Administratori i shoqërisë.

Operatori ekonomik, referuar dokumentit sipërcituar, nuk ka arritur të përmbushë specifikimet teknike me oferten e tij për artikujt e tabelës, pasi nuk ka paraqitur skedën teknike kërkuar në kriter për markat e ofruara e të listuara në tabelën përkatëse. Mangësia e skedës teknike bën të pamundur vlerësimin e ofertës në lidhje me verifikimin e parametrave të artikujve të ofruar me specifikimet teknike të kërkuara në DST.

Komisioni i Prokurimi Publik thekson, se për sa kohë autoriteti kontraktor përcakton specifikimet teknike dhe kriteret në funksion të tyre për mallrat e kërkuar, ato duhet të përmbushen nga operatorët ekonomikë, me qëllim që të sigurohet se pajisjet e ofruara përmbushin të gjitha parametrat e kërkuara në DST.

Operatori ekonomik është palë e interesuar në përmbushje të të gjitha kërkesave të DST, me qëllim fitimin e kontratës, ndaj ofertimi i pajisjeve në përputhje me specifikimet teknike është i rëndësishëm.

Komisioni thekson, se është barrë e operatorit ekonomik ofertues në procedurën e prokurimit objekt-shqyrtimi, të vërtetojë se me pajisjet e ofertuara, në rastin konkret me paraqitjen e skedave teknike, përmbush specifikimet teknike të kërkuara në DST. Jo pa qëllim AK kërkon në kriterin 2.3.2 skeda teknike, paraqitja e të cilave ndihmon autoritetin kontraktor në vlerësimin krehasuar me specifikimet teknik dhe vlefshmërinë e ofertës.

Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se autoriteti kontraktor në rastin konkret, vlerësimin e dokumentacionit të ofertuesit e ka kryer jo në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet standarde të tenderit.

Për sa më sipër referuar pretendimet e ankimesit qëndrojnë.

III.6. Lidhur me ankesën e operatorit ekonomik ankimes “PC STORE” SHPK ku ngre pretendime për mospërbushje të kriterëve për kualifikim nga operatori ekonomik “INSTANT.AL” SHPK, me argumente si vijon:

[...] Pika e ankesës, **lidhet me dyshimin** e arsyeshëm që kemi që OE INSTANT.AL nuk ka plotësuar sic duhet Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit. Referuar kërkesave për kualifikim, në DST, rezultoi se AK ka kërkuar: “2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT 1. Ofertuesi duhet të paraqesë: a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8” dhe ka bashkëlidhur në DST edhe formatin standart se si duhet të plotësohet Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit.

Duke u nisur nga fakti se OE INSTANT.AL nuk ka eksperiencë të gjatë në prokurimet publike dhe konkretisht në prokurimet publike të realizuara pas hyrjes në fuqi të ligjit 162/2020 dhe akteve nënligjore në zbatim të tij, dyshojmë që nuk ka plotësuar në mënyrën e duhur dhe nuk ka deklaruar të gjitha të dhënat që kërkohen në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit. Risjellim në vëmendje që në fazën e paraqitjes së ofertave, AK është i detyruar të pranojë si provë paraprake Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, në vend të disa vërtetimeve. Prandaj, nisur nga parashikimet ligjore, rëndësia e plotësimit në mënyrë dhe formë të përshtatshme dhe duke deklaruar cdo informacion të kërkuar në formular, merr një rëndësi determinante pasi KVO duhet të vendosë kualifikimin ose jo të një OE. Në këtë rast, kemi dyshimin e arsyeshëm që OE INSTANT.AL nuk ka plotësuar sic duhet **Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, për sa i përket kriterëve për skualifikim, deklaratave, deklaratimit të punonjësve dhe makinerive, etj.** [...]

III.6.1. Autoriteti kontraktor ka paraqitur në SPE shtojcën 8,
Shtojca 8 (Shtojcë për tu paraqitur nga operatori ekonomik)

FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT.

III.6.2 Në pikat 1 dhe 2 të nenit 82 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” përcaktohet se: “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, **autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji.** Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik. Kur autoriteti ose enti kontraktor mund t'i marrë dokumentet mbështetëse duke u futur direkt në një bazë të aksesueshme të dhënash shtetërore, në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit përcaktohet edhe informacioni që kërkohet për këtë qëllim, siç është adresa në internet e bazës të të dhënave, çdo e dhënë identifikimi dhe, sipas rastit, në deklaratën e nevojshme për dhënien e pëlqimit. Operatorët ekonomikë mund të përdorin një formular vetëdeklarimi që është përdorur gjatë një procedure prokurimi të mëparshme, nëse informacioni që ajo përmban vazhdon të jetë i saktë dhe i vlefshëm.

2. Në çdo kohë gjatë procedurës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë ofertuesve dhe kandidatëve sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, kur kjo është e nevojshme për të garantuar zbatimin korrekt të procedurës.

Ndërsa në nenin 92/3 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” përcaktohet se: “3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji...”.

III.6.3. Neni 48 pika 3 “Kushtet formale të ankesës” të Vendimit Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”,

3. Ankesa, sipas rastit, mund të shoqërohet edhe me:

a. provat dokumentare, të cilat ankimuesi kërkon të shqyrtohen nga Komisioni i Prokurimit Publik;

b. kërkesën për përjashtimin e ndonjë anëtari të Komisionit të Prokurimit Publik për shkak të konfliktit të interesit, nëse ankimuesi ka dijeni paraprakisht për shkakun;

c. kërkesën për ekspertizë të posaçme, kur kjo çmohet e nevojshme për zgjidhjen e çështjes.

III.6.4 Referuar dokumentacionit ngarkuar në SPE të operatorit ekonomik “INSTANT.AL” SHPK rezulton, se në përmbushje të Shtojcës 8, FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT ka paraqitur në SPE si pjesë të ofertë së tij dokumentin:

Formulari_permbledhes_i_vetedeklarimit_INSTANT.AL. i plotësuar në tërësi dhe i firmosur e vulosur nga administratori i shoqërisë.

III.6.5. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se është në drejtë të operatorëve ekonomikë të paraqesin pretendime mbi kundërshtimin e vendimit të autoritetit kontraktor për kualifikimin e ofertës së operatorëve të tjerë ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit, duke justifikuar kështu interesin e tyre të ligjshëm, por ndërkohë, operatorët ekonomikë nuk mund të parashtrajnë pretendime a-priori, duke iu referuar të gjitha kritereve të veçanta të kualifikimit, duke mos indentifikuar asnjë element konkret brenda kritereve të veçanta të kualifikimit, si edhe duke mos dhënë asnjë provë apo argument, se ku i mbështet pretendimet e tij. Vetë Kodi i Procedurave Administrative ka parashikuar në nenin 82 pika 1 të tij, se “Në procedurat administrative, të filluara me kërkesë të palës që inicion procedurën, barra e provës për faktet e pretenduara bie mbi këtë palë, pavarësisht nga detyrimi i organit publik për të vënë në dispozicion të palëve provat e zotëruara prej saj”.

Një ndër parimet kryesore të së drejtës është ai se “*onus probandi incumbit actori*”, se barra e provës bie mbi ankuesin. Gjithashtu, KPP gjykon, se kuadri ligjor në fuqi ka parashikuar të gjitha elementet proceduriale, përmes të cilave garantohet e drejta e informimit të operatorëve ekonomikë, në kuadër të zhvillimit të procedurave të prokurimit publik.

III.6.6. Sa më sipër, KPP gjykon, se për të mbështetur pretendimet e tij, ankimuesi duhet të kishte shoqëruar pretendimet e tij me prova, indicie dhe argumente, ose dokumentacionin përkatës, në bazë të të cilave do të shqyrtohej kjo ankesë, dhe jo me dyshime të pabazuara në prova konkrete.

Akoma më tej referuar ankesës ku ankimuesi ngre pretendime se:

OE INSTANT.AL nuk ka plotësuar siç duhet Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, për sa i përket kritereve për skualifikim, deklaratave, deklaramit të punonjësve dhe makinerive, etj. [...], Komisioni referuar DST vëren, se AK nuk ka përcaktuar kritere kualifikuese në lidhje me disponim të makinerive apo personel të kualifikuar punonjësish, çka tregon se ankimuesi ngre pretendime apriori e të pabazuara në kriteret për kualifikim.

Vlen të ritheksojmë, se Komisioni i Prokurimit Publik është organi më i lartë administrativ, i cili shqyrton ankesat mbi vendimet e marra nga KVO e autoritetit kontraktor, por ligjvënësi qartazi i ka ndarë detyrat dhe kompetencat e këtyre dy organeve. Pra, KPP nuk mund të marrë tagrin e KVO-së dhe të rivlerësojë në themel procedurën e prokurimit publik.

Operatori ekonomik ka detyrimin që ta bëjë të identifikueshëm pretendimin e tij mbi shkeljen e pretenduar, pra të evidentojë qartë dhe saktë, se ku e bazon pretendimin e tij për mospërmbushjen e kriterit/kritereve nga ana e operatorëve ekonomikë të tjerë dhe jo të shprehë vetëm mosplotësimin e tyre në mënyrë të paargumentuar. Theksojmë, se mospërmbushja e kriterit mund të vijë për shkaqe të ndryshme, siç janë mosparaqitja e një dokumenti të kërkuar, ose problematika që mund të prekin dokumentin etj. Është barrë e operatorit ekonomik që të përcaktojë, se në cilin fakt apo rrethanë e mbështet pretendimin e tij për mospërmbushje kriteri/kriteresh.

III.6.7. Komisioni i Prokurimit Publik, thekson dallimin e qartë në gjykimin e tij, ndërmjet një pretendimi të një operatori ekonomik që ngre shqetësim mbi vlerësimin hipotetikusht të gabuar të ofertës së vetë atij nga ana e autoritetit kontraktor, nga njëra anë, dhe pretendimit/prendimeve të këtij operatori apo të cilitdo operatori pjesmarrës në një procedurë prokurimi publik ndaj mënyrës së vlerësimit të autoritetit kontraktor për operatorët e tjerë konkurrentë në këtë procedurë, nga ana tjetër. Në rastin e parë, kur interesi është absolut dhe i drejtpërdrejtë, barra e provës për të argumentuar shkeljet e pretenduara të autoritetit, ndonëse sërish qëndron mbi ankimuesin, në gjykimin e KPP është arsyeshmërisht më e lehtë. KPP e mirëkupton pozitën e operatorit dhe në kuptim të misionit të tij për të siguruar efencën e procedurave të prokurimit publik, përmes nxitjes së pjesmarrjes së operatorëve ekonomikë, vlerëson se duhet të adoptojë një qendrim proaktiv, në krahasim të operatorit ankimues. Në rastin e dytë, kur operatorit pjesmarrës në një procedurë ankohet në lidhje me ofertat e operatorëve konkurrentë, pesha specifike e barrës për të provuar paligjshmërinë hipotetike të këtyre të fundit është e plotë dhe qëndron mbi kurrizin e pretenduesit, ndërkohë që KPP adapton një pozicion re-aktiv, në pritje të argumenteve të plota provuese, se përse vlerësimi i autoritetit kontraktor ka qenë i gabuar, sipas ankimuesit.

Referuar arsytimit më sipër, pretendimet e operatorit ekonomik ankimues nuk do të merren në shqyrtim.

III.7. Lidhur me ankesën e operatorit ekonomik ankimues “PC STORE” SHPK, ku ngre pretendime për mospërmbushje të kritereve për kualifikim nga operatorit ekonomik “INSTANT.AL” SHPK, me argumente si vijon:

[...]Gjithashtu, **shprehim dyshime** për mosplotësimin e kapacitetit teknik në procedurën e prokurimit nga OE INSTANT.AL. Në DST, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti teknik, është kërkuar paraqitja e dëshmive të furnizimeve të ngjashme nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurë.

Dyshojmë që ky OE nuk e plotëson këtë kriter, pasi referuar eksperiencës së pakët në fushën e prokurimit publik, mungesës së ekspertizës në procedurat e prokurimit publik [...]

III.7.1 Autoriteti kontraktor ka publikuar në SPE shtojcën 7, Formulari i Kritereve të Përzgjedhje /Kualifikimit. **2.3 Kapaciteti teknik:**

Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në çdo rast, vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përlllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

a) Autoriteti/enti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

b) Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

III.7.2 Operatori ekonomik ka paraqitur si pjesë të ofertës së tij në përmbushje të kriterit kualifikues 2.3 mbi kontrata të ngjashme, dokumentet si vijon:

1. Bashkia Mirditë Faturë elektronike Nr. 40/2022, date 26.10.2022 leshuar nga INSTANT.AL
Kompjuter+Monitor 4 cp, Printer multifunksional 2 cp, Switch 7 cp, UPS 5 cp, Maus 5 cp, Tastierë 5 cp, Ram 4 cp, Karta rrjeti 5 cp, Bllok ushqimi PC 6 cp, Xerox B205 -3 cp, Memory Card SDXC -1 cp, Antivirus -10 cp, DRUM MS 310 -5 cp, Ssd 15 cp, Fiber Tool kit-1cp. Total xxx xxx L pa TVSH

2. Bashkia Sarandë Faturë elektronike Nr. 51/2023, date 16.10.2023 leshuar nga INSTANT.AL

Tablet-1cp, Laptop Basic-2 cp, Kompjuter Desktop 2-3 cp, Kompjuter Desktop 1-9 cp Karrige zyre 120 cp Total 2.698.900 L. pa TVSH (x.xxx.xxx L. kompjutera+ 1.447.900L. karrige)

3. Bashkia Tropoja Faturë elektronike Nr. 36/2023, date 21.07.2023 leshuar nga INSTANT.AL
Kompjuter+Monitor-5 cp, PRINTER/COPY/SCAN- 1cp, Video projektor -1cp Total xxx xxx L pa TVSH + Kondicionere -2 cp -xxx.xxx L pa TVSH

III.7.3. Neni 77 “Kërkesat për kualifikim”, të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, parashikohet shprehimisht se: Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;

b) gjendjen ekonomike dhe financiare;

c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

III.7.4. Neni 40 “Kërkesa të veçanta për kontratat e mallrave”, të VKM Nr.285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikon shprehimisht se:

Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 77, të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.

4. Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në çdo rast, vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përlogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës. Autoriteti/enti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

III.7.5. Komisioni gjykon, se vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t’i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente, duhet të refuzohen si të papranueshme. Është detyrim ligjor i subjektit ofertues të provojë me dokumentacion të plotë dhe në përputhje

me kërkesat e autoritetit kontraktor, plotësimin e kriterëve të kërkuara në dokumentet e tenderit, pasi ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Akoma më tej, KPP sqaron, se në një procedurë prokurimi, subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën e tij në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme.

Nga shqyrtimi në tërësi i fakteve dhe rrethanave të çështjes objekt-shqyrtimi, KPP vëren se autoriteti kontraktor në kriterin e veçantë të kualifikimit, ka kërkuar nga ana e operatorëve ekonomikë të plotësojnë kriterin:

Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në çdo rast, vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përlllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

a) Autoriteti/enti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara

Referuar dokumentacionit të ofertës së operatorit ekonomik “INSTANT.AL” SHPK, nga shqyrtimi i dokumenteve sipër cituar, fatura tatimore shitje me ente publike (Listuar në pikën III.7.2 më sipër), rezulton, se dokumentacioni i dorëzuar në SPE nga operatori ekonomik pjesëmarrës “INSTANT.AL” SHPK për procedurën e prokurimit, nuk është në përmbushje të kriterit sa më sipër cituar nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit, pasi operatori ekonomik **nuk ka paraqitur vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës por vetëm fatura tatimore të shitjes** me ente publike, duke mospërmbushur kriterin kualifikues sipërcituar.

Komisioni i Prokurimit Publik gjykon referuar fakteve, se dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik “INSTANT.AL” SHPK, nuk përmbush kriterin e veçantë të kualifikimit, 2.3 kapaciteti teknik, pika a) në lidhje: **vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës.**

Për sa më sipër referuar, pretendimet e operatorit ekonomik ankimues qëndrojnë.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023 “Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin

e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të pranojë pjesërisht ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “PC STORE” SHPK, për procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur e Thjeshtuar”, me Nr. REF-87877-11-15-2023, me objekt “Blerje Kompjutera dhe printera për nevoja të Bashkisë Shijak”, me fond limit 2,500,000 Lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar në datën 27.11.2023, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Shijak.
2. Autoriteti kontraktor të rivlerësojë ofertat, duke skualifikuar operatorët ekonomikë “INSTANT.AL” SHPK “dhe “Blueprint Technologies” SHPK, sipas konstatimeve të këtij vendimi.
3. Autoriteti kontraktor të anulojë procedurën e prokurimit dhe në ripublikim të saj, të ketë parasysh konstatimet e këtij vendimi.
4. Autoriteti kontraktor brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi.
5. Ngarkohet zyra e financës, që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik ankimes “PC STORE” SHPK.
6. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
7. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Anila Malaj

Nënkryetar
Fiorent Zguro

